



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2022:117069

Datë: 26.02.2024

Numri i dokumentit: 05376678

C.nr.202/22

Gjykata Themelore Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Fllanza Hashani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. R. nga K... , Rr. ... nr. ... , të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K. B. , avokat nga Gj... , kundër të paditurve L. D. , nga fshati R... , Komuna Klinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L. P. avokat nga K... , dhe A. C. , pronar i N.TSH :B... P...: K... , Rr. ... nr.104, me objekt të padisë, begatim i pabazë, jashtë seancës gjyqësore me datë 26.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET propozimi i të autorizuarit të palës paditëse për kthim në gjendjen e mëparshme.

II. Revokohet aktvendimi i datës 08.02.2024, me të cilin është konsideruar e tërhequr padia e paditësit A. R. kundër të paditurve L. D. , dhe A. C.-pronar i N.T.Sh “B... P...”, K... , e dt.08.01.2022 e evidentuar në gjykatë me shenjën C.nr.202/22

A r s y e t i m

Paditësi A. R. ka ushtruar padi kundër të paditurve, L. D. , nga fshati R... , Komuna Klinë, dhe A. C. -pronar i N.T.Sh “B... P...”, K... , me objekt të padisë, begatim i pabazë.

Gjykata në seancën përgatitore të mbajtur më 26.01.2024, ka obliguar të autorizuarin e paditësit që në afatin prej 3 ditësh të rregulloj padinë në aspektin subjektiv nën kërcënimin e pasojave procedurale.

Gjykata me rastin e vlerësimit të parashtrësës për plotësimin e padisë i është referuar datës së pranimit të parashtrësës në gjykatë e dt.01.02.2024, dhe duke e vlerësuar të pasafatshme parashtrësën, e ka konsideruar të tërhequr padinë me Aktvendimin C.nr.202/22 të datës 08.02.2024.

I autorizuari i paditësit përmes parashtrësës së dt.20.02.2024 ka kërkuar kthimin në gjendjen e mëparshme, ku ndër të tjera ka theksuar se parashtrësja për rregullimin e padisë është bërë brenda afatit të përcaktuar nga gjykata.

I autorizuari i paditësit kërkesës për kthimin në gjendjen e mëparshme i ka bashkangjitur dëshmin nga zyra postare në Gjakovë, përmes të cilës vërtetohet se dërgesa në Gjykatën Themelore Pejë, për marrësin në Klinë është dorëzuar më 29.01.2024.

Pas analizimit të propozimit, gjykata vlerësoi se propozimi për kthimin në gjendjen e mëparshme është i bazuar, meqenëse sipas dëftesës për pranimin e dërgesës rezulton se dërgesa për marrësin në Gjykatën Themelore Pejë, me adresë të marrësit në Klinë, është bërë më 29.01.2024. Andaj, rrjedh se parashtrësja për plotësimin e padisë ne postë është dërguar brenda afatit 3 ditësh të caktuar nga gjykata, pasi afati fillon të rrjedh nga momenti i dorëzimit të parashtrësës në postë.

Andaj, Gjykata lejoi kthimin në gjendjen e mëparshme dhe revokoi Aktvendimin C.nr.202/22 të dt. 08.02.2024.

Andaj, gjykata bazuar në dispozitat nga neni,129.2, 133.2,133.3 dhe 387.1 k) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA THEMELORE PEJË-Dega në Klinë
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr. 202/22; dt.26.02.2024

Gjyqtarja,
Fllanza Hashani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.